




EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



TRAJNIMET DHE MANUALI MBI MJETET DIXHITALE DHE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT PËR OShC-të NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQI



AUTORËT: Irena Topalli dhe Marinela Šumanjski

REDAKTOR: Tanja Hafner Ademi dhe Tanja Bjelanović

VITI: Gusht, 2020

Ky dokument është prodhuar në kuadër të projektit EU TACSO 3, nën ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e ekipit të studiuesve dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Evropian.

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>HYRJE: PSE KY MANUAL</u>	...3
<u>QASJA DHE PARIMET NË PËRDORIMIN E MJETEVE DIXHITALE NË PUNËN E OSHC-VE</u>	...4
<u>MJETET DIXHITALE QË PËRDOREN MË SË SHUMTI NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE</u>	...9
<u>LISTA SPECIFIKE E BURIMEVE DIXHITALE</u>	...22



HYRJE: PSE KY MANUAL

Të dashur lexues,

Para se të fillojmë me përmbajtjen konkrete, dëshirojmë t'ju tregojmë më parë se si dhe pse erdhi në jetë ky manual i shkurtër.



Ky Manual u krijua nga nevoja e vazhdueshme e shoqërisë civile për të dixhitalizuar dhe përdorur teknologjitë e TIK-ut në punën e tyre, si dhe nga situata pandemike dhe reagimi emergjent ndaj saj. Kjo situatë ka ripërcaktuar dhe një herë mjedisin e punës për OSHC-të, të cilat tani duhet të punojnë në distancë për të zbatuar projektet dhe nismat e tyre, e njëkohësisht duhet të mbajnë të angazhuar anëtarët, aktivistët dhe përfituesit.

Duke qenë të vetëdijshëm për këtë situatë dhe nevojë urgjente, [EU TACSO 3](#) së bashku me [South East European Youth Network](#) kanë zhvilluar programin e ngritjes së kapaciteteve për OSHC-të nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia. Ky program synon mbështetjen e OSHC-ve në përdorimin e mjeteve dixhitale në punën e tyre të përditshme, punët me trajnimet on-line dhe aktivitetet edukative, promovimin dhe fushatë-bërjen, punë direkte në internet me përfituesit dhe, masa të tjera mbështetëse për zhvillim të aftësive sipas nevojave specifike të organizatave.



Përveç trajnimeve në gjuhët lokale të rajonit dhe në gjuhën Angleze, të ndjekura këto nga aktivitete praktike të mentoruara të pjesëmarrësve, menduam që krijimi i këtij manuali të shkurtër do të ishte i dobishëm për ju në këtë kohë. Kështu pra, ky manual synon t'ju vijë në ndihmë me njohuri mbi qasjen dhe parimet gjatë përdorimit të mjeteve dixhitale në punën tuaj, do t'ju prezantojë mjetet dixhitale më të përdorura për qëllime të ndryshme të përgjithshme dhe specifike, si dhe do t'ju prezantojë me një listë burimesh nga të cilat mund të mësoni më shumë.

QASJA DHE PARIMET NË PËRDORIMIN E MJETEVE DIXHITALE NË PUNËN E OSHC-VE

Transformimi dixhital gjithmonë ka nënkuptuar më shumë sesa thjesht adoptimin e teknologjisë. Në thelb, kjo ka qenë pjesa më e lehtë. Për të transformuar me të vërtetë, organizatat duhet të unifikojnë njerëzit, procesin, kulturën dhe teknologjinë, gjë e cila nuk është një sfidë e vogël. Kjo nuk është e pamundur dhe mund të jetë shumë e dobishme,





prandaj ne ju rekomandojmë që të dilni nga zona juaj e rehatisë dhe të filloni të eksploroni mundësitë e botës dixhitale, nëse ende se keni bërë këtë.



DISA NGA ARSYET PSE I PËRDORIM MJETET DIXHITALE NË PUNËN TONË:

- a) Shumë nga mjete dixhitale janë pa pagesë ose kushtojnë shumë pak, gjë e cila është një lehtësim për organizatat të cilat nuk kanë fonde të mjaftueshme;
- b) Përdorimi i mjeteve dixhitale mund të sjellë perspektiva të reja në punën tonë, si dhe të modernizojë metodat dhe qasjet që përdorim;
- c) Mjetet dixhitale janë shpesh herë të thjeshta në përdorim dhe ka mjaftueshëm burime nga të cilat mund të mësojmë më shumë;
- d) Shpesh herë na ndihmojnë për ta dërguar mesazhin, ftesën apo thirrjen tonë tek një audiencë më e madhe;
- e) Është mënyra më e mirë për të qëndruar rezistent

ndaj sfidave të reja që na pengojnë të kryejmë veprimtari që kërkojnë takime apo metoda pune fizike;

- f) Dhe së fundmi, ato rrisin kapacitetet tona, na bëjnë të qëndrueshëm dhe na mbajnë të përditësuar.



**SË BASHKU ME ARSYET POZITIVE PËR TË PËRDORUR TEKNOLOGJINË, EKZISTOJNË
GJITHASHTU DISA SFIDA OSE BARRIERA PËR TU KONSIDERUAR:**

- a) Nuk mund ti besojmë gjithmonë teknologjisë apo aksesit në internet;
- b) Na duhet kohë dhe përkushtim për të mësuar mjete të reja dixhitale dhe për të fituar besim në përdorimin e tyre;
- c) Nuk duhet të harrojmë grupet e ndryshme të interesit, të cilët e kemi të pamundur ti përfshijmë përmes internetit, medias sociale apo mjeteve dixhitale;
- d) Rrisqet e privatësisë dhe sigurisë duhet të vlerësohen dhe konsiderohen në fazën përgatitore dhe zbatuese;
- e) Ne duhet të jemi të hapur për të diskutuar në mënyrë kritike tema të ndryshme rreth përdorimit të teknologjisë, si ndërmjet kolegëve ashtu edhe me përdoruesit tanë.





PARIMET KRYESORE NË PËRDORIMIN E MJETEVE DIXHITALE NË PUNËN TONË

1. Para se të vendosni se cilin mjet dixhital doni të përdorni, mendoni për qëllimin dhe rezultatin që dëshironi të arrini (mos e përdorni vetëm për ta përdorur!);



2. Eksplorojeni mirë mjetin dixhital dhe shikoni gjithashtu alternativat e tij;

3. Konsideroni më parë kushtet, mjedisin dhe karakteristikat e një mjeti dixhital, si p.sh: çmimi (a përdoret mjeti specifik pa pagesë dhe cilat janë limitet apo kushtet); nëse keni nevojë për tu regjistruar; çfarë opsionesh ofron ai; a është në format vizual, audio apo tekst; a keni nevojë për ndërveprim; sa kohë duhet për ta mësuar dhe sa kohë duhet për ta përdorur; a mund të përdoret online apo offline; për çfarë pajisje keni nevojë që ta përdorni; sa pjesëmarrës apo përdorues keni dhe çfarë profili kanë ata, etj.



4. Nëse planifikoni të përdorni një mjet dixhital apo një platformë, testojeni paraprakisht përdorimin e tij/saj;
5. Përpiquni të jeni sa më kreativ për të përdorur të gjithë potencialin e mjetit dixhital-mendoni jashtë kornizës;
6. Mos harroni privatësinë dhe sigurinë kur përdorni internetin dhe mjetet dixhitale;
7. Mënyra më e mirë për të mësuar dhe fituar besim në përdorimin e mjeteve dixhitale është duke i testuar dhe provuar ato sa më shumë.



MJETET DIXHITALE QË PËRDOREN MË SË SHUMTI NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

MJETI	PËRSHKRIMI	PËRDORIMI	MË SHUMË
<p><u>ZOOM</u></p>	<p>Zoom është një mjet i përshtatshëm për video konferenca dhe konferenca në internet. Takimet dhe webinarët janë falas për pjesëmarrësit dhe ato mund të bashkohen nëse ftohen nga organizuesi. Me llogari falas mund të bëni një numër të pakufizuar takimesh 1 me 1, si dhe deri në 45 minuta takime në grup. Për më shumë opsione ju duhet të zgjidhni regjistrimin me pagesë. ZOOM mund të integrohet me një numër aplikacionesh dhe platformash të tjera, gjë e cila e bën atë të përshtatshme për t'u përdorur edhe për mësimin në internet.</p>	<p>Organizatorët dhe përdoruesit e ZOOM mund të zgjedhin të regjistrojnë seancat online apo në kompjuter, të bashkëpunojnë në projekte duke përdorur veçorinë e tabelës së bardhë, të ndajnë dokumenta ose të shënojnë shënime në ekranet e njëri-tjetrit, të punojnë në grupe më të vogla në të njëjtën kohë falë "Dhomave Breakout", të bisedojnë me të gjithë ose me individë, të ndajnë ekranin me ose pa audio, të ndajnë vetëm audion, të krijojnë një sondazh, të ndryshojnë sfondin e tyre, të reagojnë me emoji dhe të përdorin opsione të tjera. Zoom vazhdon të jetë në përditësim dhe azhurnim të vazhdueshëm duke sjellë gjithnjë veçori të reja.</p>	<p><u>KËTU GJENI MANUALIN E ZOOM</u></p>



MENTIMETER

Pasi të krijoni një llogari falas, ju do të keni mundësi të bëni një numër të pakufizuar prezantimesh për një numër të pakufizuar pjesëmarrësish (vetëm kuizet janë të kufizuar deri në 500 pjesëmarrës). Çdo prezantim mund të ketë lloje të ndryshme të faqeve; si faqe të shpejta me informacion (të ngjashme me Power Point), pyetje të llojeve të ndryshme ose pyetje kuizi. Me llogari falas mund të përdorni nga 2 deri në 5 pyetje kuizi për prezantim. Kur përdorni pyetje dhe kuize, ju mund të mblidhni përgjigjet nga pjesëmarrësit, duke i drejtuar ata që të hapin www.menti.com dhe të shkruajnë kodin për prezantimin tuaj. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit janë në gjendje t'i përgjigjen pyetjeve që shfaqen në ekran dhe përgjigjet mblidhen dhe tregohen tashmë në kohë reale.

Ky mjet dixhital mund të jetë i dobishëm për evente të mëdha ose punëtori (workshope), takime, aktivitete më të vogla. Ju mund ta përdorni atë për të paraqitur një temë, ta bëni prezantimin interaktiv, të filloni diskutimet duke bërë pyetje të hapura ose duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë që të dërgojnë pyetje në mënyrë anonime (pyetja mund të dërgohet nga një smartphone dhe shfaqet menjëherë në ekran). Ju mund të mblidhni reagime nga pjesëmarrësit ose të zbuloni mendimin e tyre në lidhje me temën e sesionit ose prezantimit tuaj. Kuizet mund të përdoren në kurse trajnimi, seminare, madje edhe konferenca si një formë e thyerjes së akullit, por edhe për të kontrolluar njohuritë e pjesëmarrësve për një temë. Është gjithashtu shumë efektive për të bërë vlerësim të shpejtë në fund të një dite trajnimi, të gjithë eventit ose seancës specifike që organizoni.

KËSHILLA SE SI TË PREZANTONI ME MENTIMETER



PADLET

Me një llogari falas në Padlet mund të krijoni deri në 7 borde (të quajtura Padlette), me skelete të gatshëm, ose nga e para, ku ju mund të zgjidhni skeletin, sfondin dhe veçori të tjera. Sapo të krijoni një Padlet, mund të ndani linkun me të tjerët që mund të kontribuojnë duke vënë shënime në të. Përveç tekstit, fotografive, imazheve, ju mund të ndani dhe link-s. Modelet e ndryshme të skeleteve ofrojnë mundësi për të riorganizuar shënimet tuaja, duke i lidhur ose organizuar ato në mënyra të tjera. Kur keni përfunduar punën në një Padlet, ju mund ta shkarkoni në formate të ndryshme (pdf, imazh, CVS ose Excel), ta ndani më të tjerë ose ta ngjisni atë direkt në faqen tuaj të internetit.

Padlet mund të përdoret sa herë që të keni nevojë për të mbledhur mendime, ide, shembuj, përvoja, etj., nga një grup njerëzish, qofshin kolegët, partnerët, anëtarët e ekipit ose pjesëmarrësit në një aktivitet edukativ. Në mësimin on-line është i përshtatshëm për aktivitete në grupe të vogla, rrahje mendimesh, mbledhjen e pritshmërive në fillim të programit, etj.

**MANUALI I
PËRDORIMIT TË
PADLET**

JAMBOARD

Jamboard është një mjet për bashkëpunim në diskutime, planifikim, rrahje mendimesh, etj. Është i thjeshtë për tu përdorur dhe ka mundësi të shtoni shënime ngjitëse, të shtoni foto, gifs, vizatime, si dhe të shkruani apo të

Është gjithashtu i përdorshëm për çdo lloj pune në grup ose ekip - në menaxhimin e projektit, bashkëpunimin mes skuadrës ose mësimin në internet. Është një mjet miqësor për përdoruesit dhe ju lejon të jeni

**SI FUNKSIONON
JAMBOARD**



	<p>shtoni elementë duke i tërhequr direkt në tabelë. Jamboard përdoret pa pagesë.</p>	<p>shumë krijues edhe pse tiparet e tij janë tepër të thjeshta.</p>	
<p><u>MINDMEISTER</u></p>	<p>Ky mjek ju lejon të krijoni “hartëzimin e ideve” (mind maps), duke bashkëpunuar me njerëz të tjerë në kohë reale. Gjithashtu, nëse keni një llogari në <u>Meistertask</u>, ky mjet mund të lidhet me këtë platformë, kështu që ju mund të përfshini ekipin tuaj dhe të vendosni detyra nga Meistertask në hartën tuaj kurplanifikoni aktivitete.</p>	<p>Mund të përdoret për çdo lloj pune bashkëpunuese me kolegët e skuadrës tuaj ose me përfituesit apo audiencën tuaj.</p>	<p><u>SI TË PËRDORIM MINDMEISTER</u></p>
<p><u>AWWAPP</u></p>	<p>Awwapp është një mjet për krijimin dhe ndarjen e “tabelës së bardhë”. Në tabelën tuaj të bardhë mund të vizatoni, shkruani tekst, postoni, etj. Tabela e bardhë mund të ndahet dhe krijohet në bashkëpunim, si dhe mund të shkarkohet dhe ruhet pasi e keni krijuar. Awwapp përdoret pa pagesë.</p>	<p>Ky mjet mund të jetë i përdorshëm në mësimin në internet në aktivitete që kërkojnë reflektim, rrahje mendimesh, apo edhe paraqitje krijuese të një koncepti, ose të vetë pjesëmarrësve. Mund të përdoret gjithashtu për bashkëpunim në ekip, për të zhvilluar ide dhe projekte.</p>	<p><u>SI TA PËRDORIM AWWAPP</u></p>
<p><u>PREZI</u></p>	<p>Kur krijoni llogarinë tuaj në Prezi, mund të filloni të bëni prezantime, duke zgjedhur së pari një model, ose duke filluar nga një prezantim bosh të cilin e modeloni vetë. Përmbajtja e prezantimit shtohet duke</p>	<p>Si një mjet prezantimi mund të përdoret në aktivitete të ndryshme edukative, seminare, konferenca, fushata, etj. Mund të përdoret gjithashtu në mësimin on-line, pasi mund të ndani linkun tuaj të prezantimit me Prezi me</p>	<p><u>SI TË KRIJOJMË PREZANTIME ME PREZI</u></p>



zmadhuar fushat (qarqet ose kutitë), ku mund të zgjidhni llojin e shkrimit, ngjyrat, paraqitjen dhe të shtoni foto, video, clip art, etj. Pasi të shtoni përmbajtjen, ju keni mundësi të zgjidhni skenarin e prezantimit tuaj, ose rendin me të cilin qarqet apo kutitë do të shfaqen në ekran. Nëse ftoni bashkëpunëtorë, mund të krijoni prezantime në ekipe. Kur prezantimi është gati, ai mund të shkarkohet për ta prezantuar offline, ose mund të prezantohet nga shfletuesi juaj i internetit. Për këtë të fundit duhet të keni akses në internet. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.

pjesëmarrësit, në mënyrë që ata ta shohin atë vetë. Karakteristika bashkëpunuese u lejon pjesëmarrësve tuaj në aktivitete online të krijojnë së bashku një prezantim mbi një temë të caktuar.

DOODLE

Doodle përdoret për të vendosur mbi orarin e një takimi me një grup njerëzish apo kolegësh. Ju mund të përdorni Doodle pa krijuar një llogari, si për krijimin e orarit ashtu edhe për pjesëmarrjen. Thjesht hapni një Doodle të re, vendosni emrin, vendin dhe hapësitat kohore të mundshme për takimin tuaj dhe më pas

Është një mjet i thjeshtë i dobishëm për të bërë plane për takime personale ose profesionale, veçanërisht me ekipe ose grupe më të mëdha. Mund të përdoret për caktimin e takimeve me kolegët tuaj, si dhe me të rinjtë ose vullnetarët që koordinoni.

SI TË KRIJOJMË NJË DOODLE



	<p>mund ta ndani linkun për pjesëmarrësit e takimit, ose mund t'i ftoni ata përmes postës elektronike (e-mail). Pasi të gjithë i janë përgjigjur sondazhit, ju mund ta mbyllni atë duke zgjedhur kohën e duhur që i përshtatet të gjithëve më mirë. Doodle mund të përdoret pa pagesë.</p>		
<p><u>POLLS GO</u></p>	<p>Ky mjet ju ndihmon të krijoni dhe publikoni sondazhe të thjeshta për audiencën më të gjerë përmes ndarjes së linkut. Nëse bëni një pyetësor në gjuhën Angleze, ju gjithashtu mund të zgjidhni pyetjet e gatshme nga aplikacioni. Polls Go mund të përdoret pa pagesë.</p>	<p>Nëse keni nevojë të organizoni një proces votimit specifik ose vendimmarrje në mënyrë anonime, ky është një mjet perfekt për të përdorur. Gjithashtu, mund ta përdorni si një kuiz të thjeshtë, apo si një ushtrim për të njohur pjesëmarrësit me njëri-tjetrin. Nuk ka nevojë të regjistroheni dhe është shumë miqësor për përdoruesit</p>	<p>Sapo të hapni linkun do të shikoni një video-tutoria përdorimi.</p>
<p><u>KAHOOT</u></p>	<p>Përmes KAHOOT ju mund të krijoni kuizin tuaj, ose të përdorni ato të krijuara tashmë nga përdoruesit e tjerë mbi tematika të ndryshme. Në mënyrë që të bëni një kuiz dhe ta prezantoni për grupin tuaj, ju duhet më parë të krijoni llogarinë duaj duke u regjistruar. Më pas procesi është mjaft i thjeshtë - ju mund të</p>	<p>Ju mund të përdorni kuizet Kahoot në çdo lloj aktiviteti edukativ, për të kontrolluar njohuritë ose qëndrimet në tema të ndryshme, por edhe për të filluar diskutimet. Mund të përdoret gjithashtu për argëtim, për të thyer akullin mes një grupi të ri pjesëmarrësish, për mbylljen e</p>	<p><u>GUIDA KAHOOT</u></p>



zgjidhni emrin dhe disa tipare vizuale të kuizit, të shtoni pyetje dhe përgjigje të shumta, zgjidhni cilën përgjigje është e saktë dhe sa kohë do t'u jepni pjesëmarrësve për t'u përgjigjur. Me opsionin e llogarisë falas ju mund të zgjidhni mes pyetjeve me zgjedhje të shumëfishta ose atyre të vërteta dhe të rreme. Ndërsa me një llogari të paguar ju përfitoni më shumë opsione. Kur dëshironi të luani kuizin me grupin tuaj, ju duhet ta projektoni atë në një ekran të madh dhe t'i kërkonti të gjithëve të marrin pjesë duke hapur faqen www.kahoot.it nga celulari i tyre, duke vënë kodin përkatës të kuizit tuaj dhe duke zgjedhur emrin e tyre si lojtarë. Pasi të gjithë emrat janë të shfaqur në ekran, mund të filloni të projektoni pyetjet dhe pjesëmarrësit do të përgjigjen përmes telefonave celular. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.

punës së grupit, për të bërë një vlerësimin, etj.

CANVA

Canva është një mjet dixhital për dizajnim dhe krijime të ndryshme vizuale. Pasi të krijoni një llogari falas në Canva, ju mund të zgjidhni nga

Përdorimi më i zakonshëm i Canva është në promovimin e aktiviteteve, projekteve, organizatave, përmes bërjes së modeleve

TUTORIALI
CANVA



dizajne të ndryshme të gatshme për postime në media sociale, infografikë, broshura, fletushka, postera, prezantime, madje edhe CV. Pastaj mund t'i ndryshoni, të shtoni tekstin tuaj ose të ngarkoni logot dhe imazhet e tjera. Ju gjithashtu mund të filloni nga e para me modelin tuaj, me dimensione të personalizuar, ngjyra dhe elementë të tjerë sipas dëshirës tuaj. Ju mund t'i ndani modelet tuaja me bashkëpunëtorë, t'i shkarkoni në formate të ndryshme (jpg, PDF etj) ose t'i ndani dhe t'i publikoni ato përmes mediave të ndryshme. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.

origjinale për mediat sociale, uebfaqet, etj. Mund të jetë gjithashtu e dobishme në aktivitete edukative, veçanërisht për prezantime, ose dhënia e informacionit përmes infografikës, si personalisht ashtu edhe në të mësuarit on-line.

ASANA

ASANA është një mjet dixhital për menaxhimin e projekteve dhe skuadrave. Pasi të krijoni llogarinë tuaj në ASANA, ju mund të krijoni projekte dhe t'i ftoni anëtarët e skuadrës të bashkohen. Ju mund të krijoni më shumë se një skuadër dhe më shumë se një projekt dhe lehtësisht mund të organizoni detyrat tuaja nëse jeni duke punuar

Përdoret më së shumti për menxhimin e detyrave mes një skuadre, ndaj dhe është një mjet i vlefshëm për menaxhim të projekteve, përgatitje të eventeve, shkrim projekti, etj.

SI TË PËRDORIM
ASANA



njëkohësisht në projekte të ndryshme me njerëz të ndryshëm. Ju mund të zgjidhni mes modeleve të ndryshme për secilin nga projektet dhe të organizoni detyrat tuaja në mënyrën më të përshtatshme për ju. Për secilën detyrë ka mundësi të ndryshme, si psh: i caktoni detyrën një anëtarë të skuadrës, vendosjen e datës apo afatit kohor, bashkëngjitni skedarët, shkëmbeni link-s, etj. Ju mund të gjurmoni përparimin punës dhe detyrave tuaja duke klikuar në Raportet, për të parë një listë të përfunduar ose detyra të caktuara, pavarësisht nga projekti. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.

SLACK

Ju mund të regjistrohni dhe ta përdorni Slack nga interneti ose ta shkarkoni aplikacionin dhe ta përdorni në kompjuter apo telefon. Mund të krijoni ose bashkoni një ose më shumë hapësira pune, të cilat janë krijuar për komunikim brenda një organizate ose grupi. Brenda një hapësire pune mund të hapni ose bashkoni kanalet ekzistuese, të cilat mund të

Slack mund të përdoret për komunikim ndërmjet anëtarëve të organizatës ose rrjetit dhe është veçanërisht i përshtatshëm për skuadra që punojnë në distancë ose udhëtojnë shumë. Kjo ju ndihmon të mbani kontakte me anëtarët e skuadrës tuaj rregullisht ose të lehtësoni punën në ekip kur shkruani projekte të reja, menaxhoni

SLACK 101



	<p>lidhen me projekte, skuadra ose tema të ndryshme që lidhen me punën tuaj ose të rëndësishme për komunitetin tuaj. Është e mundur të integroni shumë aplikacione dhe mjete të ndryshme që ju përdorni tashmë në Slack-un tuaj, kështu që ju mund të shkëmbeni materiale përmes Google Documents dhe Drive, të bëni telefonata në grup përmes Zoom-it, të ndani kalendarët e ndryshëm ose dhe të luani lojëra sëbashku. Mund ti ndani links-at e me kompani dhe biznese me të cilat punoni rregullisht - si klientë, shitës dhe partnerë - për të sjellë të gjithë njerëzit e duhur në të njëjtën dhomë. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.</p>	<p>projekte, organizoni aktivitete, etj. Mund të përdorni aplikacione shtesë të integruara në Slack, në mënyrë që të keni gjithçka që ju nevojitet në një vend . Mund të përdoret gjithashtu për administrimin e komuniteteve (si anëtarët e organizatës suaj ose miqtë dhe përkrahësit, etj.), menaxhimin e vullnetarëve ose pjesëmarrësve në një projekt.</p>	
<p><u>POPPLET</u></p>	<p>Popplet është një mjet dixhita të cilin mund ta përdorni për të krijuar vizualizime të ideve tuaja apo prezantime kreative. Duke krijuar një llogari falas ju mund të përdorni vetëm 1 Popplet. Por pasi e keni përfunduar mund ta shkarkoni atë, ta ruani në kompjuterin tuaj dhe ta fshini nga llogaria juaj Popplet. Kështu</p>	<p>Me tekst, imazhe dhe video, Popplet ju lejon ta përdorni në të gjitha gjuhët. Qoftë për shkollë, për punë apo për veten tuaj, Popplet ju ndihmon të shihni se çfarë mendoni dhe si e mendoni. Popplet ndihmon në krijimin, vizualizimin, organizimin dhe ndarjen e ideve. Përdoreni</p>	<p>Në faqen kryesore të Popplet gjeni dhe instruksionet e përdorimit në mënyrë vizuale.</p>



	<p>do keni sërisht hapësirë për të krijuar një Popplet të ri. Me krijimin e një llogari të paguar ju përfitoni të gjitha opsionet shtesë dhe një numër të pacaktuar Popplet-esh. Popplet mund të përdoret pa pagesë.</p>	<p>atë për të ndërtuar gjithçka, nga listat e thjeshta deri në afatet kohore apo hartëzimin e ideve.</p>	
<p><u>PIKTOCHART</u></p>	<p>Krijoni një llogari falas në Piktochart për të krijuar dhe dizenuar infografikë, postera, prezantime vizuale të ndryshme. Përmes llogarisë falas ju mund të krijoni duke përdorur modelet e gatëshme dhe duke i adaptuar ato, ose duke nisur një model të ri që mund ta krijoni me përmasat, ngjyrat, elementët dhe grafikët që ju preferoni. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.</p>	<p>Piktochart ju vjen në ndihmë për të krijuar prezantime, postera, infografikë, etj, të bukur vizualisht të cilët mund ti ndani në rrejetet tuaja sociale ose ti printoni për evente fizike. Mund ta përdorni nga interneti ose ta shkarkoni si aplikacion në kompjuterin tuaj.</p>	<p><u>SI TË PËRDORIM PIKTOCHART</u></p>
<p><u>FREEPIK</u></p>	<p>FREEPIK është një platformë me fotografi, ilustrime, ikona, dizenjime të cilat ju mund ti shkarkoni pasi të regjistroni një llogari falas. Mes mijëra produkteve që ju ofrohen mund të përdorni ato që janë falas për të bërë prezantimet apo publikimet tuaja më interesante dhe ilustrative. Për ti përdorur</p>	<p>Foto, ilustrimet apo ikonat mund t'ju shërbejnë në dizenjime posterash, broshurash, prezantimesh të ndryshme apo për ti ndarë në rrjetet sociale.</p>	<p><u>MANUALI I PËRDORIMIT FREEPIK</u></p>



	fotografitë duhet të përdorni ose referoni emrin e autorit/autores.		
<u>SLIDESGO</u>	Slides go është faqja perfekte për të shkarkuar prezantime të ndryshme në Power Point, me dizenjo që mund ti zgjidhni sipas kategorive apo tematikave të ndryshme. Mjeti është i kufizuar për përdorim falas.	Slides go ju ndihmon të bëni prezantime vizualisht të bukura, të dizenuara profesionalisht dhe ju lejon të zgjidhni mes stileve, temave dhe ngjyrave nga më të ndryshmet.	<u>SLIDESGO TUTORIAL</u>
<u>REMOVEBG</u>	Removebg është një mjet dixhital që ju lejon të modifikoni fotografitë tuaja duke i hequr ose ndryshuar sfondin. Mund ta përdorni direkt duke ngarkuar një foto dhe duke i ndryshuar sfondin ose duke i hequr sfondin e bardhë, pa pasur nevojë të regjistroheni me një llogari. Krijimi i një llogarie të paguar ju lejon ti shkarkoni fotografitë e modifikuar në version dhe rezolucion të madh për printim.	Përdoret lehtësisht për modifikimin e logove, duke u hequr sfondin e bardhë ose për të ndryshuar sfondin e fotografive të ndryshme në mënyrë që të krijoni prezantime sa me estetike dhe vizualisht të pastra.	<u>SI TË PËRDORIM REMOVEBG</u>



ISSUU

Issuu i jep çdo krijuesi dixhital mundësinë për të ngarkuar dhe shpërndarë botimet e tyre në të gjithë botën. Në vetëm disa minuta, ju mund të regjistroni një llogari bazike, të ngarkoni publikimet tuaja dhe ti shpërndani ato në rrejt aq herë sa dëshironi. Me një logari të paguar ju mund të shihni gjithashtu dhe statistikat e çdo publikimi, si përshembull të shikoni sa vetë e kanë klikuar apo lexuar publikimin tuaj.

Issuu është mjaft i përdorshëm kur doni të ngarkoni në rrjet dokumenta si raportet vjetore, studimet që kryeni, raporte monitorimi etj., të cilat pasi ti ktheni në version PDF mund ti ngarkoni në llogarinë tuaj dhe linkun ta shpërndani në faqet tuaja të mediave sociale ose ta ngjisni në faqen tuaj zyrtare.

TUTORIALE SI TË PËRDORNI ISSUU



LISTA SPECIFIKE E BURIMEVE DIXHITALE

MJETI	PËRSHKRIMI	PËRDORIMI	MË SHUMË
GJUHASHQIPE.COM	Këtu mund të gjeni softuerë të përshtatur për gjuhën shqipe, drejtshkrimin dhe terminologjinë TIK. Duke klikuar mbi link ju mund të shkarkoni falas aplikacionin Drejtshkrimori, ta instaloni në kompjuterin tuaj dhe ta përdorni atë gjatë punës tuaj.	Drejtshkrimi i gjuhës Shqipe do t’u vijë më së miri në ndihmë kur përpiloni raportet, dokumentat apo artikujt tuaj. Duke e instaluar atë në kompjuterin tuaj do të mund të shkruani qartë dhe pa gabime drejtshkrimore.	UDHËZUES PËR INSTALIMIN E APLIKACIONIT
TECHSOUP ALBANIA	TechSoup Global, është organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në vitin 1987 me bindjen se teknologjia është shtytës i fuqishëm për ndryshime në shoqëri. Që atëherë, krijuan një rrjet botëror me individë dhe organizata që kanë bindje të njëjtë. Ky punon bashkërisht në zhvillimin dhe këmbimin e zgjidhjeve inovative për sfidat tona urgjente shoqërore.	Techsoup Shqipëri ofron donacione teknologjike për organizata të ndryshme. Ju mund të lexoni kriteret dhe të aplikoni për donacione softuresh si Office, BitDefender, etj., të cilat nëse kualifikoheni mund ti merrni falas ose me një çmim të reduktuar.	KATALOGU TECHSOUP



PROTIK

Protik është një qendër e pavarur e Teknologjisë së Komunikimit të Informacionit jofitimprurës, objektivat parësore të së cilës janë rritja e kërkesës dhe përdorimi i TIK-ut dhe ndihma në rritjen e tregut, forcimi i aftësive njerëzore dhe institucionale, rritja e bashkëpunimit midis sektorit privat, institucioneve arsimore dhe qeveria, të sigurojë sipërmarrësit e TIK-ut qasje në teknologjinë moderne dhe njohuritë, dhe të shërbejë si një qendër e rrjetit të informacionit.

Protik organizon evente të ndryshme të fokusuara në TIK, ndaj duke ndjekur faqen e tyre mund të gjeni aktivitete interesante nga të cilat mund të zhvilloni njohuritë tuaja më tej në fushën e TIK.

Më shumë informacion gjeni në faqen e tyre ueb dhe mediat sociale.

ALBANIAN ICT ACADEMY

Albanian ICT Academy ofron metodat më inovatore të edukimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Misioni i tyre është të sjellin inovacion në edukimin e të rinjve dhe të apasionuarve, si dhe të zhvillojnë njohuritë e komunitetet në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike në Shqipëri duke ofruar metodologji të

Ju mund të përdorni kurset e tyre profesionale për të trajnuar stafin tuaj, sikurse dhe të mësoni më shumë mbi zhvillimet teknologjike në Shqipëri. Përveç kurseve ICT Academy zhvillon dhe projekte interesante, si: Vajzat në TIK, STEM Albania, Java e Kodimit, Makerspace etj.

METODOLOGJIA E TRAJNIMIT



	mësimdhënies bashkëkohore në forma praktike dhe interaktive.	
<u>YOUTHONLINEWORK</u>	YouthOnlineWork është një faqe e cila i vjen në ndihmë profesionistëve të lirë, duke krijuar një hapësirë pune dhe edukimi për ta. Platforma ofron kurse të ndryshme online përmes video tutorialeve që i aksesoni në kanalin e saj në Youtube.	<u>KURSET ONLINE</u>
<u>ALMOOC</u>	Almooc.com ose Albanian Massive Open Online Courses është platformë edukative që bashkëpunon me profesorë të botës shqiptare për t'ju ofruar klasa online të gjithëve, falas.	<u>KURSET ONLINE</u>
		Ju mund të regjistroheni në një nga kurset që ofron kjo platformë në tema si: këshillim karriere, dizajn grafik, marketing dixhital dhe dizajnim faqesh online. Kurset mund ti ndiqni online me shpjegim në gjuhën shqipe.
		Almooc përveç hapësirës së kurseve për fëmijë dhe të rinj, ju mundëson të ndiqni online dhe kurse të ndryshme në TIK si dizajnimi i web-it, mësimet mbi Wordpress, bazat e menaxhimit të projektit, bazat e prezantimit, etj.

MANUAL ME TË GJITHA MJETET DIXHITALE: <http://digiyouth.seeyn.org/>